

MIRATOHET

MINISTRI

STATUT

I UNIVERSITETIT "JUSTINIANI I PARE"

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Universiteti "JUSTINIANI I" është universitet privat, i krijuar në baze të ligjit Nr. 8461, datë 25.02.1999, i ndryshuar, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 156, datë 22.3.2001, "Për shkollat private në Republikën e Shqipërisë" dhe lejes së posaçme të dhënë me Vendimin nr. 156, datë 15.03.2006 të Këshillit të Ministrave.

Neni 2

Universiteti "JUSTINIANI I" është person juridik i njohur me vendimin Nr. 30929, datë 03.02.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane.

Adresa e saj është : Bulevardi "Zogu i I" (në krah të Ministrisë së Drejtësisë)

Neni 3

Universiteti "JUSTINIANI I" është Institucion i Arsimit të Lartë i nivelit universitar dhe pasuniversitar. me dy fakultete : Fakultetin e Drejtësisë dhe Fakultetin e së Drejtës Nderkombetare dhe Diplomaci. Fakulteti përbehet nga tre departamente dhe administrata.

Neni 4

Universiteti "JUSTINIANI I" ka për qëllim:

Te pergatise specialiste te larte ne fushen e shkencave juridike me formim te pergjithshem.

Te kryeje studime dhe kerkime ne fushen e shkencave juridike.

Te kryeje kualifikimin shkencor pasuniversitar, kurse te specializimit dhe kurse te kualifikimit afatshkurter dhe afatgjate per juristet.

Neni 5

Mesimi zhvillohet ne gjuhen shqipe.

Universiteti eshte jopolitike, kombetare dhe laike.

Neni 6

Personeli mesimor - shkencor i Universitetit "JUSTINIANI I" gezon liri akademike ne procesin mesimor dhe ne kerkimin shkencor ne kuptimin e ligjit "Per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise". Nr.9741, date 21.5.2007 I ndryshuar .

Neni 7

Te gjitha mjediset e Universitetit "JUSTINIANI I" gezojne paprekshmeri ne kuptimin e ligjit "Per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise". Nr.9741, date 21.5.2007 I ndryshuar .

Neni 8

Universiteti "JUSTINIANI I" ka te drejte

Te miratoje planet dhe programet e veta mesimore;

Te miratoje tekstet ne perdorim te studenteve te saj;

Te perzgjedhe personelin akademik dhe personelin administrativ;

Te perzgjedhe studentet qe regjistrohen cdo vit akademik;

Te anetaresohet ne shoqata e organizata kombetare dhe nderkombetare universitare;

Te krijojte lidhje bashkepunimi me universitete dhe fakultete analoge brenda dhe jashte vendit.

Neni 9

Universiteti "JUSTINIANI I" detyrohet:

Te zhvilloje procesin mesimor e shkencor sipas standarteve te percaktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkences dhe te pergatise juriste te nivelit bashkekohor.

Te raportoje ne Ministrine e Arsimit dhe te Shkences ne fund te cdo viti akademik per veprimtarine e saj mesimore - shkencore.

Ne bashkepunim me Ministrine e Arsimit dhe te Shkences te kryeje brenda 5 vjeteve pas marrjes se lejes procesin e vleresimit dhe te akreditimit, i cili behet i njohur per publikun.

Perballon me shpenzimet e veta procesin mesimor dhe shkencor. Kostoja e pergatitjes se studenteve te jete me e larte se ajo e studenteve ne shkollat publike.

KREU II

ORGANET DREJTUESE TE UNIVERSITETIT "JUSTINIANI I"

Neni 10

Organet drejtuese te Universitetit "JUSTINIANI I" jane : rektori dhe senati.

Neni 1

Rektori

Rektori eshte organ monokratik i emeruar nga asamblea e ortakeve dhe administratori i shoqerise. Marredheniet me shoqerine percaktohen ne kontraten e punes.

Rektori duhet te kete titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar".

Marredheniet ndermjet shoqerise dhe rektorit percaktohen me kontrate. Rektori ka keto kompetenca:

- a) drejton dhe perfaqeson Universiteti "JUSTINIANI I";
- b) eshte kryetar i Senatit dhe ka te drejten e vetos mbi vendimet e tij;
- c) emerom dhe shkarkon Dekanin e Fakultetit te Drejtesise dhe personelin akademik dhe administrativ te tij, kur nuk i permbahen kushteve te percaktuara ne kontrate;
- d) shfuqizon vendimet e Keshillit Shkencor te Fakulteteve.
- e) leshon diplomat e perfundimit te studimeve universitare dhe pasuniversitare por nuk ka te drejten e delegimit te firmes personave te tjere per kete kompetence;
- f) miraton planin kalendarik te procesit mesimor;
- g) jep leje per hyrjen e forcave te rendit ne mjediset e shkolles dhe mund t'i therrase ato ne rast nevojje;

Senati

Senati është organ epror kolegjal i Universitetit "JUSTINIANI I". Ai vendos për problemet me të rëndësishme mesimore shkencore të kësaj shkolle.

Anetaret e Senatit përfaqesojnë personelin mesimor e shkencor dhe duhet të kenë titull shkencor. Ata mund të jenë pedagogë të brendshëm ose të jashtëm.

Senati përbehet nga 13 anetare; 12 prej tyre zgjidhen nga personeli akademik; Rektori është anetar dhe kryetar i Senatit për shkak të detyrës.

Mandati i Senatit është tre vjet; zgjedhjet zhvillohen sipas rregullores së posaçme. ...

Senati mbledhet në seanca të zakonshme një herë në dy muaj me thirrjen e Rektorit.. Rendi i ditës propozohet nga Rektori dhe miratohet nga Senati. Ai mund të mbledhet edhe në seanca të jashtëzakonshme me thirrjen e Rektorit.

Senati ka këto kompetenca :

- a) përcakton drejtimet kryesore të punës mesimore dhe kërkimore shkencore.
- b) miraton në shkallë të dytë planet mesimore të Fakultetit të Drejtësisë dhe të Fakultetit të së Drejtës Nderkombëtare dhe Diplomaci
- c) i bën kërkesë Këshillit të Akreditimit për vlerësimin e cilesive dhe akreditimin e kurseve të studimit
- d) përcakton normat vjetore të ngarkesës mesimore shkencore për personelin akademik;
- e) miraton Statutin dhe Rregulloren e shkolles
- f) miraton rregullat dhe programet e kualifikimit pasuniversitar
- g) miraton propozimet e Këshillit Shkencor të fakulteteve për dhenien e titujve shkencore;

KREU III

ORGANET DREJTUESE NE FAKULTET

Neni 13

Fakultetet e Universitetit janë njësi kryesore që bashkërendojnë mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fushat mësimore-kërkimore të përafërta ose të ndërthurura.

Departamentet janë njësi bazë mësimore-kërkimore që përfshijnë fusha kërkimi homogjene dhe grupojnë disiplinat mësimore respektive.

Organet dhe autoritetet drejtuese të tyre janë: Dekani dhe Këshilli i Fakultetit.

Neni 14

Dekani

Dekani është drejtuesi kryesor i fakultetit dhe emërohet në detyrë nga rektori. Marrëdhëniet me shoqëritë përcaktohen në kontratën e punës.

Dekani duhet të ketë titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar". Dekani i Fakultetit ka këto kompetenca :

- a) drejton të gjithë punën mesimore e shkencore të fakultetit;
- b) organizon përzgjedhjen e studenteve që pranohen të rinj çdo vit akademik;
- c) miraton rregulloret e brendshme të departamenteve dhe të administratës;
- d) emëron stafin akademik të brendshëm e të jashtëm që pranohet me konkurs.
- e) emëron përgjegjësit e departamenteve;
- f) drejton shkollat dhe kurset pasuniversitare të fakultetit;
- g) miraton komisionet e provimeve;
- h) vendos për përjashtimin nga shkolla të studenteve universitare dhe pasuniversitare.

Neni 15

Këshilli Shkencor

Këshilli Shkencor i fakultetit është organ epror kolegjial, i cili vendos për problemet më të rëndësishme me karakter mesimor dhe shkencor.

Këshilli Shkencor përbëhet nga 13 vota dhe zgjidhet nga stafi akademik, Kryetar i tij është Dekani i fakultetit për shkak të detyrës.

Mandati i Këshillit Shkencor është tre vjeçar. Këshilli Shkencor ka këto kompetenca :

- a) miraton planin mesimor të fakultetit;
- b) miraton programet mesimore të fakultetit;
- c) miraton tekstet në përdorim të studenteve;
- d) i propozon Senatit strategjinë e zhvillimit të fakultetit;
- e) miraton rregullat dhe programet e kualifikimit pasuniversitar;
- f) miraton propozimet e departamenteve për dhënie të titujve shkencorë:

Neni 16

Zevendesdekani

Drejton, organizon dhe kontrollon punën mesimore shkencore. Ndjek zbatimin e planeve dhe të programeve mesimore. Harton planin kalendarik të procesit mesimor. Harton orarin e mesimeve e të provimeve dhe ndjek zbatimin e tij.

Ndjek plotësimin korrekt të dokumentacionit shkollor nga sekretaria mesimore të cilën e ka në varesi të drejtperdrejte.

Ushtron të gjitha kompetencat e Dekanit në mungesë dhe me urdher apo porosi të tij.

Kancelari

Kancelari është specialist me formim të lartë juridik ose ekonomik e financiar dhe me përvojë të lartë organizuese.

Kancelari menaxhon veprimtarinë ekonomike, financiare e administrative të fakultetit. Ai organizon kontroll revizionin e brendshëm dhe bën analizë me karakter ekonomik financiar të cilat ia paraqet dekanit për shqyrtim.

Kancelari përgjigjet për arketimin e kuotave të studentëve, si dhe për shlyerjen e detyrimeve të fakultetit ndaj organeve shtetërore, për pagimin e taksave, tatimeve, si dhe për detyrimet ndaj të tjerëve.

Neni 18

Departamenti

Departamenti është njësi bazë mesimore shkencore e fakultetit. Departamenti mbulon disa disiplina shkencore të ngjashme.

Fakulteti i drejtësisë përbëhet nga tre departamente : departamenti i të drejtës publiko-nderkombetare , departamenti i të drejtës civile dhe departamenti i të drejtës penale.

Ne departament përfshihet gjithë stafi akademik, i brendshëm dhe i jashtëm, sipas disiplinave përkatëse.

Departamenti ka këto kompetenca :

- a) shqyrtton planet mesimore dhe i propozon Këshillit Shkencor ndryshimet përkatëse;
- b) shqyrtton programet mesimore dhe bën ndryshimet e nevojshme;
- c) shqyrtton dhe miraton tekstet mesimore;
- d) realizon programin mesimor sipas planit të miratuar dhe kontrollon cilësinë e mesimdhënies
- e) përcakton tematikën e punës shkencore dhe kontrollon realizimin e saj;
- f) realizon kualifikimin shkencor pasuniversitar afatshkurter dhe afatgjate;
- g) propozon dënimin e titujve shkencore për stafin akademik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU IV

FINANCIMI I SHKOLLES

Neni 19

Universiteti "JUSTINIANI I" është institucion privat me vetefinancim. Te ardhurat e saj formohen nga tarifat e studenteve dhe nga te ardhura te tjera te ligjshme.

Ajo ka te drejte te pranoje ndihma financiare qe lidhen me objektin e veprimtarise se saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

Ajo paguan rregullisht taksat, tatimet dhe detyrimet e tjera ndaj shtetit dhe ndaj te treteve. Pjesa qe mbetet perben fitimin e saj.

Neni 20

Veprimtaria ekonomike pasqyrohet ne bilancet tremujore dhe vjetore te shkolles. Ajo mban kontabilitet te rregullt sipas legjislacionit ne fuqi.

KREU V

STUDIMET UNIVERSITARE

Neni 21

Studimet e ciklit të parë DNP , në institucion vazhdojnë minimalisht tre vjet me kohë të plotë (*full time*). Vitet kalendarike ndahen në vite akademike.

Studimet e ciklit të dytë, në institucion vazhdojnë minimalisht dy vjet per DND dhe nje vit per MNP me kohë të plotë (*full time*). Vitet kalendarike ndahen në vite akademike.

Studimet e ciklit të tretë, në institucion vazhdojnë dy vjet(tre semestra) per MND me kohë të plotë (*full time*) dhe tre vjet per Doktoraturen . Vitet kalendarike ndahen në vite akademike.

Kalimi nga njëri vit te tjetri bëhet pasi studenti të ketë shlyer detyrimet e vitit të mëparshëm.

Studenti mund të qëndrojë në shkollë mbi kohën normale të studimeve, duke shlyer detyrimet sipas planit mësimor dhe duke paguar tarifën vjetore.

Neni 22

Pranohen për t'u rregjistruar shtetasit shqiptarë ose të huaj që plotësojnë këto kushte:

vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë shtetit (ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës);

vërtetojnë me dokumente zyrtare transferimin nga një institucion publik ose privat i arsimit të lartë që ushtron veprimtarinë e saj në Shqipëri ose jashtë shtetit;

pranojnë pagimin e tarifës së caktuar mujore ose vjetore.

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga një komision i caktuar nga dekanati mbështetur në dokumentacionin e paraqitur si dhe nëpërmjet intervistës.

Numri i pranimeve bazohet në mundësitë reale të fakultetit për një mësim normal dhe brenda standarteve të kërkuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

Neni 23

Lejohet transferimi i studenteve në vitet ndërmjetese nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose private në Universitetin "JUSTINIANI I" dhe anasjelltas, pasi të bëhet ekuivalentimi i provimeve, sipas planeve mesimore përkatëse.

Neni 24

Në përfundim të studimeve dhe pasi shlyen të gjitha detyrimet e përcaktuara në planin mësimor të fakulteteve përkatëse fitohen diplomat të ciklit të parë, ciklit të dytë dhe ciklit të tretë të studimit me këto tituj:

1. Në Fakultetin e Drejtësisë

- DNP në Drejtësi
- DND në Juridik
- MNP Jurist i përgjithshëm
- MND në shkencat penale
- DR në shkencat juridike

2. Në Fakultetin e Drejtës Nderkombetare dhe Diplomaci

- DNP në Drejtën Nderkombetare dhe Diplomaci

Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni. Për studentet që mbarojnë studimet me medalje të Arte, organizohet një ceremoni në shkallë rektorati dhe dorëzimi i diplomave bëhet nga rektori, në prani të presidentit të kompanisë, përfaqësuesve të senatit dhe profesorit.

Neni 25

Në përputhje me ligjin "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" pranë Universitetit organizohet kualifikimi afatshkurter dhe afatgjate pasuniversitar.

Propozimin për kursin e kualifikimit afatshkurter ose afatgjate e ben departamenti perkates; ky propozim shqyrtohet ne Keshillin Shkencor te fakultetit dhe ne Senatin e shkolles se larte. Senati e percjell propozimin konkret per miratim ne Ministrine e Arsimit dhe te Shkences.

Neni 26

Afati i studimeve për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, fushat e kualifikimit, kriteret e pranimit, përcaktohen në përputhje me Ligjin e arsimit te larte, Vendimin e Këshillit të Ministrave për kualifikimin shkencor pasuniversitar dhe për klasifikimin e punonjësve pedagogjikë e kërkimorë dhe udhezimet e MASH .

KREU V

TE DREJTAT DHE DETYRA TE STUDENTEVE

Neni 27

Studenti e fiton kete status juridik me regjistrimin ne Universitetin "JUSTINIANI I" dhe e humbet me marrjen e diplomes ose me perjashtimin e tij nga shkolla. Studenti eshte i detyruar te permbushe te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga Statuti dhe rregullorja e kesaj shkolle.

Studenti ka te drejte :

- a) te perfitoje nga procesi mesimor dhe te diplomohet pasi te shlyeje te gjltha detyrimet e percaktuara ne planin mesimor;
- b) te perdore mjediset e shkolles per realizimin e programit mesimor;
- c) te organizohet ne shoqata studentore jopolitike, sipas percaktimeve te akteve ligjore perkatese
- d) te marre pjese ne veprimtari artistike, kulturore, sportive, argetuese te organizuara nga shkolla jashte procesit mesimor"
- e) te ndikojte ne permiresimin e procesit mesimor nepermjet formave demokratike te shfaqjes se vullnetit;
- f) te degjohet nga organizmat perkatese, para se te merret ndonje mase ndeshkuese kunder tij;

KREU VII

PUNESIMI DHE KUALIFIKIMI

Neni 28

Punesimi

Personeli në institucion përbëhet nga:

- a) personeli akademik (punonjësit mësimorë e shkencorë) të brendshëm e të jashtëm, i kategorizuar sipas nenit 47 të ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar ;
- b) personeli administrativ;
- c) personeli i shërbimit.

Vendet e punës për shkronjën "a" dhe "b" fitohen me konkurs.

Neni 29

Kontrata e punës për personelin në shërbim të rektoratit lidhet nga rektori, në shërbim të fakultetit lidhet nga dekani.

Kontrata e punës me personelin akademik, të brendshëm e të jashtëm, mund të lidhet pa afat ose me afat një vjeçar.

Kontrata e punës për gjithë personelin lidhet dhe zgjidhet sipas legjislacionit të punës.

Neni 30

Koha e punës dhe e pushimit

Koha e punës për personelin është jo më tepër se 40 ore në javë dhe jo më shumë se 8 ore në ditë. Kjo kohë pune mund të jetë më e shkurter për personelin akademik.

Pushimi vjetor për punonjësit mësimorë e shkencorë është 12 ditë pushim i zakonshëm. plus 36 ditë pushim plotësues, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 220, datë 24.05.1994.

Problemet e tjera lidhur me kohën e punës dhe të pushimit përcaktohen në kontratën e punës. sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 31

Norma mësimore shkencore

Punonjësit mësimorë e shkencorë janë të detyruar të plotësojnë normën mësimore shkencore, sipas përcaktimeve në kontratën e punës. Kualifikimi shkencor dhe rezultatet në punë lidhen drejtpërdrejt me nivelin e pages.

Mungesat në orët mësimore konsiderohen shkelje të rënda të disiplinës në punë.

Neni 32

Kualifikimi

Personeli akademik gëzon të drejtën e kualifikimit shkencor, sipas kritereve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 786, datë 17.12.1998 "Për kualifikimin shkencor pasuniversitar dhe për klasifikimin e punonjësve pedagogjikë e kërkimorë", i ndryshuar dhe në aktet e tjera nënligjore.

Ky kualifikim mund të bëhet brenda Universitetit privat "Justiniani I" ose jashtë tij, brenda ose jashtë vendit.

Kualifikimi shkencor për personelin akademik inkurajohet dhe krijohen lehtësitë e mundshme, sipas përcaktimeve në kontratën e punës.

KREU IX

VULA ZYRTARE DHE STEMA

Neni 33

Universiteti "Justinian i I" ka vulën zyrtare ku shkruhet UNIVERSITETI "JUSTINIANI I", TIRANE.

Universiteti ka edhe stemën e vet me të njëjtin mbishkrim.

KREU X

Neni 34

Sigurimi i brendshëm i cilësisë

Universiteti "Justiniani i I" është përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe ka ngritur njësinë përkatëse të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në to merr pjesë edhe një përfaqësues nga organizimet studentore të Institucionit, si dhe një përfaqësues ekspert i jashtëm. Njësia vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore apo artistike, si dhe të veprimtarive administrative e financiare të institucionit. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit.

KREU XI

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 35

Bashkangjitur me këtë Statut, universiteti ka edhe Rregulloren e vet, e cila rishikohet, të paktën, një herë në tri vjet nga Senati Akademik.

Secili Fakultet dhe njësiti e tjera të këtij institucioni hartojnë rregulloret e veta.

Neni 36

Ky Statut u miratua nga Senati Akademik i Universitetit “Justinian i I”.

Tirane me 28.09.2008

**SHKOLLA E LARTE PRIVATEUNIVERSITARE
"JUSTINIANI I" TIRANE**

AUTORITETET DREJTUESE

1. Prof. Dr. Ismet ELEZI - Dekan
2. L.L.M Adnor SHAMETI - Zv. Dekan
3. Mirela SHAMETI - Kancelare

DEKANI

Prof.Dr. Ismet ELEZI

Tirane me 15.09.2006

PERSONELI ADMINISTRATIV

- 1. Kryesekretare mesimore** : te kete arsim te larte juridik, njohuri per kompjuterin dhe nje pervoje pune te pakten pese vjecare ne administraten shteterore ose ne sektorin privat, mundesisht ne arsimin e larte. - Ermira LEKA
- 2. Sekretare:** te kete arsim te larte, njohuri per kompjuterin dhe te pakten dy gjuhe te huaja : anglisht, italisht. - Najada Bregu.
- 4. Bibliotekare - internet:** Te kete arsimte larte juridik ose ne ndonje fakultet tjetër te shkencave humane; mundesisht te kete pervoje rreth si bibliotekare, te njohe kompjuterin dhe te jete ne gjendje te kryeje shërbimin e internetit per studentet, - Bukuriye Zyla.
- 5. Pastruese:** Te jete e afte per kryerjen e detyres dhe e sjellshme, - Besa Aliaj.

KANCELARI
Mirela SHAMETI

Tirane me 15.09.2006